

INTERVISTË ME SARANDA BOGUJEVCIN

Prishtinë | Data: 7 shkurt, 2018

Kohëzgjatja: 84 minuta

Të pranishëm:

- Saranda Bogujevci (E intervistuar)
- Aurela Kadriu (Intervistuesja)
- Donjetë Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Saranda Bogujevci: Unë jom Saranda Bogujevci.

Aurela Kadriu: A mundesh me na tregu diçka prej kujtimeve tua të hershme të fëmijësisë? Domethonë çkado që t’kujtohet prej familjës, rrethit ku je rritë, lojnat si fëmijë, gjithçka që mbanë n’mend?

Saranda Bogujevci: Unë jom rritë me një rreth të familjës shumë t’gjanë. Edhe gjithmonë jom konë e rrethume prej fëmijëve tjerë po edhe prej familjarëve domethanë. Se kujtimet e fëmijësisë i kom kujtime shumë t’mira. Si fëmijë m’kujtohet që kemi kalu kohë shumë jashtë më fëmijët e tjerë. Domethanë kemi pasë, tash po flas për domethanë lojnat që i kemi pasë si fëmijë n’vitet ‘90-të. Domethanë jonë konë disa që jonë konë specifike kështu që i kemi pasë. Po masandej m’kujtohet që shumë, shumë here kemi kriju edhe lojna t’reja. Dhe gjithë si fëmijë e kom dashtë muzikën shumë, m’ka pëlqy me vallëzu shumë. S’e di, ka shumë, shumë kujtime të ndryshme. Unë jom rritë edhe me fëmijët e axhës, kështu që jemi konë një numër i madh i fëmijëve domëthanë edhe... S’e di, domëthanë prapë kur e kujtoj fëmijësinë, e kujtoj kohën që kom kalu domethanë, jashtë që kemi lujtë.

Masanej kom ëndërru shumë, bashkëbisedojsha me shoqni qysh si fëmijë kom pasë qef shumë me mësu m’i ra pianos, kom pasë qef me kanë balerinë masanej. Kom pasë qef me kanë gazetare, a din, qysh me thanë andrra, andrra t’ndryshme. Po si... kom pasë edhe përvoja t’ndryshme si fëmijë. Në moshën gjashtë ose shtatë vjeç kemi migru me familje në Suedi, për shkak që u pat keqësu situata në Kosovë. Domethanë po flasim për vitet, fillimin e ‘90-tave, kur babi ish largu prej punës. Kur i’a kom fillu unë shkollës, veç sa na kanë marrë objektin e shkollës, domethanë kanë qenë vetëm fëmijët serb që kanë shku. Nuk na osht’ leju neve që t’shkojmë n’objektin që osht’ dashtë, kështu që jonë ba improvizime.

Aurela Kadriu: Ku e keni kry edukimin fillestar?

Saranda Bogujevci: Në Podujevë. Domethanë, në qytetin e Podujevës. Edhe masanej kemi emigru atje, domethanë kemi emigru në Suedi. Atje kom jetu një vit e gjysë. Atje kom kujtime shumë t’mira domethanë... Kemi qenë t’vendosur me një vend koxha t’izoluar për shkak që na kanë mbajtë vetëm kush kanë qenë azilant domethanë. Ka pasë edhe prej vendeve tjera, po numri ma i madh i familjeve që kane qenë t’vendosura aty, kanë qenë prej Kosovës. Po prapë se prapë, unë si fëmijë kom pasë, kom pasë kujtime t’mira, n’shkollë atje, n’ambientin ku kemi jetu... Po që tani mbas një viti e gjysë

domethanë prapë na kanë kthyer në Kosovë edhe pjesën, deri në mas t'përfundimit t'luftës kemi jetu në Podujevë.

Aurela Kadriu: Çka ka punu baba që e kanë largu prej punës?

Saranda Bogujevci: Ka qenë elektrikist në Obiliq.

Aurela Kadriu: Edhe kur jeni kthyer prej Suedisë në Kosovë, a na tregon çfarë gjendje e keni gjetë? Qysh ka qenë për juve?

Saranda Bogujevci: M'kujtohet ka qenë dimri nëse nuk gaboj, se m'kujtohet ka qenë ftoftë. Edhe si fëmijë ashtu e kom përjetu njëfarë kaosi, po në të njëjtën kohë nuk e kom kuptu bash mirë se çka osht' duke ndodhë. Ma s'pari nuk e kom kuptu arsyen pse kemi shku në Suedi ashtu jo... Nuk e kom kuptu në kuptimin që po përkeqësohet situata në Kosovë edhe jonë tu ndodhë gjana t'kqija. Ka qenë ndryshimi masandej shumë i madh i kushteve që i kemi pasë, të kushteve që i kemi pasë në Suedi domethanë kur kemi jetu atje, n'krahësim masandej me Kosovë. Fillon me i vretë dallimet. Në shkollë për shembull kushtet që i kom pasë në Suedi kanë pasë dallim shumë t'madh me kushtet që i kom pasë në Kosovë, domethanë në Podujevë.

Kështu që m'kujtohet njëfarë lloj kaosi, nuk e di ashtu moti ftoftë edhe... Sidomos si fëmijë ka shumë gjana që nuk i din edhe ka shumë gjana masandej që nuk i kupton. Po prapë është prapë adaptohesh me, me përditshmëri kudo që je.

Aurela Kadriu: A na tregon raportin me, me familje? Me prindërit, me motrat, me vëllezërit brenda familjes, a ki kujtime me ta?

Saranda Bogujevci: Po, patjetër. Kom pasë, kom shumë kujtime t'mira. Po thom unë jom rritë me fëmijët e axhës, domethanë jom rritë me një rreth shumë t'gjanë të familjës. Edhe gjithëherë kom ndi kujdes, e kom ndi një dashni t'madhe prej familjës. Kom qenë koxha e vogël kur ka, kur ka vdekë babgjyshi po që e mbaj n'mend edhe atë kujdesin e tina. E kemi pasë një ritual, që n'mëngjes kur jemi zgju prej gjumit, gjithëmonë e kemi pritë se e kemi ditë që ka dalë me ble çokollada për neve. Kështu që, ka qenë ritual i përditshëm prej babgjyshit domethanë që gjithëherë... Kështu që, edhe pse kam qenë shumë e vogël, pesë vjeç diku kur ka vdekë babgjyshi, po prapë i mbaj n'mend ato kujtime.

Aurela Kadriu: Cili ishte viti kur u kthyet prej Suedisë?

Saranda Bogujevci: Domethanë nëse nuk gaboj kemi shku në 1990 domethanë, mbas një viti, një viti gjysë jemi kthyer.

Aurela Kadriu: A e keni vazhdu mandej shkollën? A ka pasë mundësi me vazhdu shkollën kur je kthyer?

Saranda Bogujevci: Po, patjetër. Klasën e parë e kom fillu në Podujevë, masanej në gjysëm vjetorin e dytë të klasës t'parë kemi shku në Suedi. Kur jom kthyer m'ka ra dikun n'klasën e tretë, qashtu diçka, m'u

kthy domethanë. Kanë qenë nxansat e njejtë, shokët edhe shoqet e klasës kanë qenë t'njejtë. Mësuesja ka qenë e njejtë. Kështu që nuk osht' që m'ka ra diçka me fillu prej fillimit edhe mos me njoftë kërkond. Faktikisht ma e vështirë ka qenë për vllaun, ka qenë një vit ma i ri se unë për shkak se atij... Ai ka fillu shkollën në Suedi n'fakt masanej kur jemi kthy në Kosovë i'u ka dështë prapë me një sistem tjetër me fillu, domethanë klasën e parë.

Aurela Kadriu: A keni qenë n'objekt shkollorë apo nëpër shtëpi?

Saranda Bogujevci: Kemi qenë domethanë, çerdhja e qytetit që ka qenë, praj klasës t'parë deri n'klasën e katërt kemi qenë aty. Masandej prej klasës t'pestë deri n'klasën e tetë kemi qenë me një objekt ku ish dashtë me majtë mësim nxanësat e shkollës t'mesme. Po për shkak që kemi qenë ne ma të vegjël osht' shfrytëzu ai objekt për neve doemthanë. Ndërsa nxanësat që kanë qenë t'shkollës t'mesme qysh osht' e njoftun nëpër krejt Kosovën kanë mbajtë mësim në shtëpia private.

Aurela Kadriu: E a ki kujtime? A e mban n'mend shkollën? Çka kishe mujtë me na veçu prej shkollës fillore?

Saranda Bogujevci: Gjatë shkollimit, gjatë shkollës fillore kom kalu shumë mirë, n'kuptimin me shokë edhe shoqe edhe mësimdhanësat që kanë qenë aty. Po kushtet nuk i kemi pasë t'mira. Dhomethanë objekti nuk i ka përmbushë kushtet për me mbajtë mësim tamam. Domethanë dimrit osht' dashtë me ngrohë objektin përmes stufave në secilën klasë. Osht' dashtë familjet me kontribu për me mujtë me i ble drutë. Domethanë nuk i ka përmbushë kushtet për mësim.

Po pa marrë parasyshë asaj anës kom shumë kujtime t'mira me shokë edhe shoqe. Edhe ka qenë një kohë shumë e vështirë për shkollim. Pra po thom për shkak që nuk jonë, nuk jonë konë kushtet e përshtatshme n'atë kohë. Domethanë gjithë e përmendi që kom qenë ajo gjenerata e të '90-ave që kanë pasë tjetër përvojë. Po prapë t'njejtën kohë ka pasë dallime edhe prej qytetit n'qytet. Për shembull, kushtet që i kanë pasë për mësim në Prishtinë, kur flas domethanë me shoqinë që i kom tash që kanë qenë n'shkollë fillore gjatë qasaj periudhe kohore... kur i shkëmbejmë kujtimet që i kemi pasë, dallojnë shumë. Kur e mendon për shembull sa osht' larg Podujeva me Prishtinën e kom fjalën edhe ka pasë dallime.

Po prapë se prapë unë kur i mendoj gjanat jom shumë mirënjohëse për mundësinë që e kom pasë m'u shkollu. Normal për krejt kujtimet e mira, po thom, që i kom pasë me shokë edhe me shoqe. Dhe te qajo mundësia që mu ka kriju, pa marrë parasyshë që kanë qenë kushtet shumë t'vështira prapë kemi arritë m'u shkollu.

Aurela Kadriu: A na tregon, ju keni qenë t'vogël, po a keni ndi qetë presionin e situatës, mësuesja n'shkollë a ju ka folë, mandej arsimtarët ma vonë? Qysh ju kanë folë në raport me komplet gjendjen politike që ka qenë n'vend n'atë kohë?

Saranda Bogujevci: Për qaq sa e mbaj n'mend unë, nuk osht' që kemi qenë t'ekspozumë n'atë aspekt. Jonë, jonë përqendru domethanë arsimtarët, mësuesja, jonë përqendru me na shkollu dhe nuk na

kanë ngarku n'aspekt politik. Fundi i fundit kemi qenë fëmijë edhe sa kemi mrrijtë na me, me kuptu qatë situatë domethanë. Nuk osht' që nuk jemi kanë t'vetëdijsëm çka po ndodhë përreth po jo me qenë ashtu t'ngarkumë. M'kujtohet domethanë as nuk e kemi pasë, tash po flas personalisht për vete domëthanë, nuk m'kujtohet që kom ndje naj frigë gjatë qasaj kohe. Ma vonë, domethanë ka fundi i të '90-ave, po. Edhe jom kanë ma e rritun po edhe osht' vrejtë ma shumë. Domethanë ma herët jo shumë. Po prapë se prapë këto jonë përvoja që dallojnë shumë prej njani tjetrit.

Aurela Kadriu: A keni mrri me përfundu shkollën fillore?

Saranda Bogujevci: Jo. Kur kam qenë n'klasën, m'fal, kur kom qenë n'klasën e tetë domethanë qatëhere tamam ka fillu lufta edhe kemi shku ashtu me ndërpreme. Edhe dikur masnej osht' ndërpre mësimi komplet për shkak që nuk kemi pasë siguri. Edhe kur ka përfundu lufta jemi kthy prapë në klasën e tetë, me përfudnu klasën e tetë para se me vazhdu n'shollë t'mesme, që unë nuk e kom mbri ata për shkak që masnej kom shku në Angli për shërim.

Aurela Kadriu: A na tregon qyshdo që e mbanë n'mend, periudhën e luftës?

Saranda Bogujevci: . Është vështirë me harru. Po, e mbaj n'mend shumë mirë. M'kujtohet kur u folke për bombardimet e NATO-s. Edhe m'kujtohet kur osht' marrë vendimi me 24 mars, kur kanë fillu bombardimet e NATO-s e kemi pasë ashtu një gëzim, "Tash kemi me qenë t'libër". Edhe nuk e kemi paramendu kurrë që kanë me ndodhë gjanat që kanë ndodhë mbas bombardimeve të NATO-s.

Për neve ka qenë pak më ndryshe për shkak që gjanat i kemi, i kemi pa dhe i kemi vrejtë ma vonë, po flas për anën e Llapit. M'kujtohet kur ka qenë masakra e Reçakut, domethanë kur ka ndodhë sulmi ndaj familjës Jashari. T'gjitha këto, edhe osht', qysh me thanë, osht' folë shumë n'shollë. Edhe pse ish qaq afër në të njejtën kohë disi ishte e pabesueshme që po ndodhin qato gjana.

Edhe masanej kur, kur... lajmi që do të fillojnë bombardimet e NATO-s, tash kom qenë fëmijë unë, për qaq sa kom mujtë me kuptu, për mu ka qenë, kom mendu që n'momentin qe fillojnë bombardimet e NATO-s kemi me qenë t'libër. Edhe, po n'fakt brenda qasaj periudhe kur kanë qenë bombardimet e NATO-s ka pasë vrasje shumë t'mdhaja ndaj familjeve shqipëtare. Edhe ka pasë momente t'caktume, për shembull m'kujtohet një herë kur për shkak... Shtëpinë e kemi në qendër të qytetit edhe ka qenë ashtu kolonë e tankeve t'mëdha që kanë hy prej Serbisë, qe dilshim n'dritare me i pa. Edhe ka qenë koxha e frikshme, e imagjinojshe domethanë çka mundet me ndodhë.

Edhe ka pasë masanej raste tjera. Për shembull patën shpërthy dy bomba në qytet. Po ka qenë interesant për shkak qe n'mendje teme unë e kom pasë gjithëherë këtë mendimin që osht', ksi gjana nuk munden me i ndodhë familjës tem. Osht' diçka e pamundun, ashtu jom kanë shumë e sigurtë. Edhe domethanë, çka do që t'kisha pasë edhe t'kisha përjetu, prap e kisha pasë qatë bindjen që osht' e pamundshme me i ndodhë familjes teme diçka.

Masandej pas bombardimeve të NATO-s që ka qenë më 24 mars, katër ditë ma vonë, me 28 mars ka hy një njësit rezervist i policisë domethanë, qe thirrën "Shkoripiona", që jonë i njejt njësit që kanë marrë

pjesë në masakrën e Srebrenicës në Bosnje. Kanë hy në qytet edhe na kanë marrë komplet çka kemi qenë gra edhe fëmijë. Burrat nuk kanë qenë më neve n'atë moment për shkak që vajza e axhës, Nora, patë kërkim me dalë edhe u folke në qytet që nëse hyn ushtria serbe i marrin burrat edhe i vrasin. Edhe masnej ka qenë kërkesa që ata me dalë, për shkak që mendojshim që jemi gra dhe fëmijë, na largojnë prej shpise qysh i kanë largu t'gjitha familjet tjera. Edhe qysh me thanë, s'e di a kanë mendu m'u largu, me shku nëpër kampet ku kanë qenë në Shqipëri apo Maqedoni, apo nëpër male ku kanë qenë pjesa ma e madhe qytetarëve. Edhe askush nuk e ka mendu që, edhe pse nuk osht' që nuk e kemi pa ma herët që jonë vra gratë dhe fëmijë.

Dhe domethanë na kanë largu prej shpise ushtarët. Kemi kalu domethanë nëpër oborre t'kojshive tjerë edhe njonë prej... domethanë në një oborr të një kojshisë aty afër që e kemi na kanë vendosë t'gjithëve. Kemi qenë unë me nanën, dy vllazënitë, gjyshën, gruja e axhës me pesë fëmijët e axhës që jam rritë me ta. Ka qenë halla e babit me ne, edhe ka qenë familja e një shokut t'babit edhe t'axhit, Enver Duriqit, domethanë komplet, prindërit, gruja edhe katër fëmijët. Edhe domethanë na kanë vendose mbrapa shtëpisë edhe kanë fillu me gjujtë domethanë. Unë edhe katër, domethanë prej t'gjithëve vetëm unë edhe katër fëmija e axhës, Jehona, Fatosi, Genci edhe Liria kemi mbijetu. T'gjithë kemi qenë t'plagosun.

Domethanë masi, masi që ka ndodhë ngjarja, kanë, kanë, jonë largu ushtarët, masnej ka ardhë njësitë i rregullt edhe na ka dërgu në spital në Prishtinë, ku kemi qëndru deri në përfundim t'luftës. Edhe ma vonë domethanë, ndoshta mas një muji, ka mrri babi edhe axhi me kuptu ku jena edhe çka ka ndodhë përmes një shokut t'klasës të Jehonës që e kemi taku në spital. I cili ka shku, jo që ka qenë i plagosun po ka pasë probleme tjera edhe masnej ka mbetë n'spital. Edhe kur ka ardhë baba i tij me marrë e ka njoftë babin edhe mandej ka mrri me gjetë edhe me njoftu që na jena, na jena n'spital. Edhe tek atëherë e kanë kuptu se çka ka ndodhë me familjen.

Aurela Kadriu: A keni qenë e shtrirë në spital?

Saranda Bogujevci: Po.

Aurela Kadriu: A na tregon qatë periudhë n'spital? A kanë qenë mjekët shqiptarë?

Saranda Bogujevci: Urdhno?

Aurela Kadriu: Mjekët nuk kanë qenë shqiptarë, a po?

Saranda Bogujevci: Jo. Ka qenë, në fillim e kom taku sa kam qenë në shok dhomë, e kom taku një motër medicinale që ka qenë shqipare. Edhe veç m'kujtohet që m'pat thonë, nuk e di as emrin, as mbiemrin, nuk kom mrri me pa ma edhe me ditë kush u konë. Veç m'kujtohet që m'pat thonë, "Mos fol kurgjo se t'kuptojnë krejt". Edhe ma vonë e kom kuptu që t'gjithë e kanë ditë gjuhën shqipe, vetëm nuk kanë dashtë me folë. Edhe tjetra osht' që për media e kanë dhanë, domethanë kanë fo... Nëse ka pasë media qoftë nga Serbia, qoftë ndërkombëtar iu kanë thanë që kemi, jemi t'plagosun prej NATO-s. Edhe tek ma vonë e kom marrë vesh, e kom kuptu domethanë që kjo ka qenë storja.

E masandej e kom kuptu çka ka deshtë me thanë motra që kom taku, për shkak që faktikisht nëse na kishim folë tamam se çka ka ndodhë ishim kanë n'rrezik për jetë. Edhe masandej kur na pytke neve dikush m'vike shumë inat me thanë që kjo ka ndodhë prej NATO-s. Po në të njejtën kohë u dashke me mendu për sigurinë, edhe temen edhe të fëmijëve t'axhës. Kështu që e kemi përdorë, patëm vendosë kështu... E patëm diskutu me fëmijët e axhës edhe patëm vendosë që kush do që t'na pyte i thojmë veç që e kemi ndi ni zhurmë t'madhe edhe ma nuk na kujtohet kurgjo, domethanë deri sa ka përfundu lufta.

Aurela Kadriu: A ju kujtohet kur, qysh ka ndodhë mandej që ju keni lëvizë prej spitalit? A ka mrri baba me ardhë më ju gjetë aty?

Saranda Bogujevci: Po, babi ka ardhë. Kanë ardhë s'bashku me Enverin, me shokun e tij. Enveri gjatë gjithë kohës osht' mundu me i gjetë fëmijët e tij. Domethanë atij i'u ka vra e gjithë familja. Domethanë katër fëmijët, gruaja edhe prindërit. Edhe unë kur pat' hy mjeku edhe ka thanë, "Ka ardhë babi". Mendojsha që dikush i afërm që ka jetu në Prishtinë, e ka kuptu ku jemi edhe ka ardhë me na vizitu. Dhe kurrë nuk e kom mendu që, që vjen babi. Ai normal që ka qenë shumë moment i vështirë edhe për neve, po t'njejtën kohë edhe për babin edhe për axhën kur e kanë kuptu çka ka ndodhë.

Masandej babi i osht' dashtë m'u kthy prapë nëpër male. Edhe mas disa jave ka ardhë axha, i cili masandej ka nejtë te, te daja i tij që ka pasë shtëpiat në Kodër të Trimave. Edhe ata na kanë ndihmu shumë, edhe i kanë ndihmu axhës shumë çdo herë që ka ardhë me na vizitu n'spital. Për shkak që gjatë gjithë kohës ka qenë i rrezikuar deri sa ka ardhë n'spital prej Kodrës të Trimave për me na pa. Ka qenë gruaja e djalit të dajës të tij që gjithëherë e ka shoqnu vetëm që mos... me qenë domethanë një gru aty, me shpresën që nuk e malltretojnë policia apo ushtria nëse e shohin rrugës deri sa t'vjen me na pa neve.

Aurela Kadriu: E di që osht' e vështirë Saranda, po a mundesh veç me na tregu qatë momentin baba kur e ka marrë vesh për çka ka ndodhë, besoj që t'kujtohet.

Saranda Bogujevci: Më vjen keq po qetash nuk...

Aurela Kadriu: Okej, ju kuptoj. Në momentin, a na tregon qysh ka ndodhë që keni shku në Angli?

Saranda Bogujevci: Masi që ka përfundu lufta ka qenë axha me, me një vizitë domëthanë, ka ardhë më na vizitu t'gjithëve. Edhe rastësisht i kemi pa disa ushtarë të KFOR-it, kanë qenë të KFOR-it britanez. Edhe ka qenë edhe vajza e axhës të tij, që edhe e ka ditë gjuhën. Edhe kanë vendosë me shku edhe me iu tregu se çka ka ndodhë. Në momentin që iu kanë tregu na kanë marrë domethanë, edhe kemi qenë nën kujdesin e mjekëve të KFOR-it britanez.

Masanej e kemi taku një, një mjek që ende jemi në kontakt me to. Edhe përmes një sistemi që e kanë, që thirret *telemedicine*... ku i marrin t'dhanat edhe diagnozën për pacientë t'ndryshëm edhe i dërgojnë tek mjek t'ndryshëm nëpër botë, domethanë që janë specialista për çfarëdo lëndimi që kanë pasë ose

sëmundjeve, cilado qoftë. Edhe masandej një mjek në Angli ka thanë që mundem me i trajtu vajzat. Edhe kështu që përmes KFOR-it britanez dhe shtetit britanez normalisht na osht' ofru ndihmë domethanë për me, na osht' ofru mundësia me shku edhe m'u shëru në Angli. Ku masandej edhe kemi mbetë, kemi... na osht' dhënë e drejta e qëndrimit edhe ma vonë edhe shtetësia.

Aurela Kadriu: Çfarë lëndimesh keni pasë ju, Fatosi, Liria edhe tjerët?

Saranda Bogujevci: Genci, Fatosi kanë qenë t'plagosun n'kambë, domethanë dy kambët. Liria ka qenë ma s'keqti, Liria ka qenë e pagosun n'fyt, domethanë për tetë mujë osht' dasht m'u ushqy direkt përmes stomakut. Për fat masi që osht' operu në Angli osht' shumë ma mirë tash. Jehona ka qenë e plagosun në t'dy krahët, n'dorë edhe n'kambë. Edhe unë kom qenë e plagosun n'dorë, n'kambë edhe n'shpinë.

Aurela Kadriu: A na tregon udhëtimin qysh ka ndodhë, që keni shku deri atje? Qysh osht' bo e mundshme, a e mbani n'mend?

Saranda Bogujevci: Po mendoj kjo ka ndodhë përmes oraganizatave t'caktume që jonë kanë ktu edhe që jonë marrë me këto procedura. Po mu m'kutjohet që për një kohë, nashta ma shumë se një muj ose qashtu diçka, gjithmonë jemi kanë kështu gati. Se na thojshin që duhemi me nejtë gati, për shkak që n'momentin që merret vendimi masanej menjihere nisemi për në Angli. Qatë ditë që jemi nisë m'kujtohet ka qenë një tentë, nëse s'gabohem ka qenë aftër aeroportit, ku kemi pritë deri sa jonë kry t'gjitha procedurat.

Masanej jemi nisë me aeroplan ushtarak. Osht' dashtë ta ndrojmë në Itali për shkak të disa defekteve që i ka pasë. Edhe masnej prej Italisë kemi shku, kemi fluturu direkt në Angli. Prej aeroportit me ambulancë, une edhe vajza e axhit, Jehona, kemi shku direkt në spital. Ndërsa pjesa tjetër e familjës jonë dërgu me një kamp ku kanë qenë refugjatë nga Kosova, që i kanë çu ma herët në Angli. Domethanë kemi, kemi ndejtë në kamp rreth një vit e diçka, ashtu, një vit. Edhe masandej na osht' dhanë mundësia që secili, domethanë secila familje të vendoset në shtëpitë e tyre, atyre që iu kanë dhanë leje qëndrimin.

Aurela Kadriu: A erdhën edhe baba e axha me juve?

Saranda Bogujevci: Po, patjetër.

Aurela Kadriu: A na tregon qatë një vit e gjysë atje? Çka do që t'kujtohet prej atij viti, kur keni shku në kamp?

Saranda Bogujevci: Ah...

Donjetë Berisha: Edhe cili vit ka qenë kur keni shku n'kamp?

Saranda Bogujevci: Ka qenë shtator i '99-ës. Domethanë disa mujë masi që ka përfundu lufta. Kanë qenë disa familje nga Kosova, për shkak që ka pasë kampe, edhe n'pjesët tjera domethanë jonë kanë t'vendosuna në Manchester. Domethanë në pjesë t'ndryshme të Manchesterit kanë qenë edhe kampet tjera që ka pasë refugjatë tjerë. Pjesën ma t'madhe t'kohës unë e kom kalu n'spital. Në fillim, domethanë dikun n'janar të 2000-tës kom fillu shkollimin, domethanë n'shkollë t'mesme ka ra, në *high school* [shkollë të mesme]. Edhe, po edhe aty domethanë prapë pjesën ma t'madhe t'kohës u dashtë me shku ndoshta gjysëm dite n'shkollë masandej me... ose u dashtë me pasë fizioterapi, ose kom pasë, domethanë termine tjera për dorë, për shkak se dorën e kom pasë t'dëmtume ma s'shumti.

Edhe ka qenë një përvojë interesant, po çka m'ka pëlqy në Angli osht' sa i organiz... si komunitete sa jonë t'organizuar. Për shembull kemi pasë shumë ku... domethanë penzioner që kanë qenë kanë pasë kohë ma shumë. Masandej u organizojshin udhëtime ditore ku dy pleq kishin kohë ashtu, e vishin i pytshin t'gjthë nëse don dikush me shku me vizitu diçka në një vend ose... domethanë gjithëhere qytetarët që jonë kanë përreth kampit ku kemi jetu, jonë mundu n'mënyrën e tyne me na ndihmu. Qoftë edhe veç me t'thirrë me dalë me pi ni kafe ose me t'çu me pa një vend interesant. Jonë kanë shumë, shumë t'organizumë. Qysh me thanë, edhe sa i përket bashkësive fetare, gjithë kanë qenë ashtu t'organizumë. Secili osht' mundu në mënyrën e vet me t'ndihmu çfarëdo forme që... ose çkado që ti ke pasë nevojë.

Ka qenë, qysh me thanë, ka qenë shumë e vështirë për shkak që kemi shku me një vend t'ri, nuk e kemi ditë gjuhën, gjithë ato gjana që i kishim përjetu në Kosovë. Masandej pjesa tjetër e familjës ish në Kosovë edhe... nuk u kanë e lehtë. Kemi pasë për shembull familjarë, e kemi pasë hallën në Londër edhe pse për çdo javë ka ardhë, osht' kujdesë për neve, ka kalu kohë me neve. Po prapë kur je me një ambient t'panjoftun, ka qenë e vështirë. Po në përgjithësi domethanë ka qenë përvojë e mirë, n'kuptimin që shumë jonë kujdesë për neve.

Aurela Kadriu: Kur keni shku n'shkollë, a na tregon qysh ka qenë ambienti i shkollës si është bërë socializimi?

Saranda Bogujevci: Normal që sistemi i shkollimit atje osht' komplet ndryshe. Por, përveç asajna, kushtet në shkollë, në krahasim me kushtet që i kom pasë në Kosovë ka dallim shumë t'madh. Shkolla...

Donjetë Berisha: Shkollën a e keni fillu masi që e keni fitu shtetësinë?

Saranda Bogujevci: Jo, para.

Donjetë Berisha: Para. Domethonë gjatë kohës që keni qenë n'kamp?

Saranda Bogujevci: Po, domethanë edhe refugjatët që kanë shku...

Donjetë Berisha: E domethonë të gjithë refugjatët, fëmijët që kanë qenë, kanë shku n'shkollë?

Saranda Bogujevci: Po, po, e ki të obligueshme.

Donjetë Berisha: Ka qenë n'kuadër t'kampit shkolla apo ju kanë dërgu dikun...

Saranda Bogujevci: N'shkollë kemi qenë n'shkollë normal si tjerët. Tjetra çka ka qenë interesant që shkolla ka qenë katolike. Edhe tregojke, masanej patëm majtë kontakt edhe raport me drejtorin e shkollës masi që ka dalë n'penzion. Edhe na tregojke që kur ka ardhë kërkesa për me i pranuar... për shkak që n'shkollë kanë qenë s'pari t'pranuar refugjatët që kanë shku në maj të '99-ës kanë shku refugjatë prej Kosovës në Angli. Edhe kur i kanë pytë domethanë drejtorin edhe bordin e shkollës për me i pranuar nxanësat, po edhe që s'kanë qenë të fesë krishtere, po kanë qenë musliman... edhe masandej drejtori ja u ka bo pytjen, a din, "Nëse na jemi shkollë e krishtere edhe nuk po i marrim njerëzit që kanë nevojë ma s'shumti për neve, atëherë çka jemi tu ba na?" Kështu që osht' vendosë domethanë prej bordit t'shkollës që me i marrë t'gjithë refugjatë. Kështu që ka pasë nxansa n'shkollë ma herët, para se me shku na.

Donjetë Berisha: E a e kanë pasë problem gjuhën?

Saranda Bogujevci: Ka qenë e vështirë po kemi pasë arsimtarë që na kanë ndihmu vetëm me gjuhë. Jo shqiptarë, anglez, po që çdo orë t'msimit kanë qenë me neve edhe na kanë spjegu mësimet, çkado që osht' ligjërë, që ka funksionu shumë mirë. Po nuk i kemi pasë dhomëthanë, jonë kanë të përqendurë s'pari, ma shumë rreth gjuhës, me msu gjuhën.

Pjesa e Dytë

Saranda Bogujevci: Mu m'ka pëlqy arti, kështu që nuk u kanë problem shumë i madh me i kuptu detyrat në orën artit kështu që m'kanë pytë edhe kom shku. Edhe nuk e kemi pasë t'detyrushme me, me i mjetë orët e njejta qysh i kanë majtë nxanësat. Për shkak që e kanë kuptu situatën.

Aurela Kadriu: A ka pasë klasë veç me shqiptarë apo kanë qenë...

Saranda Bogujevci: Jo, kemi qenë t'përzimë. Kemi qenë t'përzimë edhe nuk ka qenë numri ashtu shumë i madh që kanë qenë shqiptarë. Domethanë t'vetmën, kohën e vetme që kemi qenë s'bashku osht' kur kemi pasë domethanë arsimtar apo arsimtare që na kanë mësu gjuhën. Po aty ka pasë edhe prej vendeve tjera. Për shembull unë e kom pasë një shoqe që ka ardhë prej Hong Kongut dhe ka qenë pjesë e qasaj klase. Edhe çka m'ka pëlqy n'shkollë në Angli, ashtu që kurrë nuk e kom ndi që na kanë kqyrë me keqardhje. N'kuptimin, tamam ashtu vetëm si viktimë me u pa. Po jonë mundu ashtu me na trajtu normal me kujdes, po me qenë t'barabartë me nxanësat tjetërë. Edhe ajo normal na ka shërby shumë, mendoj. Edhe ka qenë shumë mirë.

Aurela Kadriu: Me shokë edhe shoqe t'klasës raporti qysh ka qenë?

Saranda Bogujevci: Shumë mirë, jonë kanë shumë t'kujdesshëm, edhe jonë kujdesë... Më kujtohet domethanë n'fillim ish koxha vështirë me, me komunikimi me njeni tjetrin, për shkak që unë nuk e dijsa gjuhën mirë. Po për shembull m'kujtohet n'kohën e drekës, për shkak që atje drekën e ke pasë mrenda n'shkollë, s'kanë leju me dalë jashtë shkollës. Edhe n'kohën e drekës për shembull, atje funksionon sistemi ndryshe, e ki klasën tande domethanë që e kemi... me spjegu n'kuptimin që me mujtë me kuptu këtu në Kosovë osht' për shembull kujdestaren e klasës që e ke pasë, klasën. E ke pasë n'qasi forme, domethanë kujdestarën e klasës ose kujdestarin edhe klasën. Masandej klasët tjera që ke shku qoftë nëse ka qenë për art, matematikë apo shkencë, gjeografi kanë qenë, jonë kanë t'ndamë në grupe. Ti domethanë nuk je kanë gjithëherë me të njejtit njerëz në të njejtat klasa. Je kanë viti i njejtë po jo t'gjithë kanë qenë, nuk i ke pasë gjithë të njejtin me nji klasë.

Edhe për shembull n'kohën e drekës kur kom shku për me marrë ushqim edhe mu ulë dikun, domethanë gjithëherë m'kanë marrë prej qasaj klasës t'kujdestarës edhe jom ulë me qatë grup edhe kurrë nuk m'kanë lanë ashtu mos me ditë ku me shku mu ulë, a din, tu mos e njoftë kërkon. E kështu që kanë qenë shumë t'kujdesshëm n'qatë kuptim. Edhe jonë kanë shumë t'mirë, kurrë nuk e kom ndi veten ashtu që jom e vetmume edhe nuk kom me kon me ndejtë, dhe pse nuk e di gjuhën.

Aurela Kadriu: A kanë mbri ata me kuptu çka ka ndodhë, përvojën tande?

Saranda Bogujevci: Po. Kom folë, projektin domethanë, kur i kemi pasë provimet e diplomimit domethanë për shkollë t'mesme, në art e kom pasë nji skulpturë që e kom punu që e tregon historinë e familjës. Masandej kur e kanë kuptu se çka ka ndodhë, m'pat ftu njeni prej arsimtarëve që e jepke landën e studimeve fetare domethanë... edhe m'pat ftu me folë me nxanësat edhe me ju spjegu nëpër çka kom kalu unë që ata me kuptu ma shumë edhe me ja ditë me nji farë forme vlerën jetës ma shumë. Tani masandej prej aty kom fillu edhe shumë shpesh m'ka ndodhë që m'kanë ftu shkolla t'ndryshme ku kom shku edhe kom folë rreth asaj çka ka ndodhë.

Aurela Kadriu: Mbas shkollës t'mesme çka keni vazhdu?

Saranda Bogujevci: Mbas shkollës t'mesme kom vazhdu domethanë shkollimin që në Angli ju thojnë *A levels*, kolegji domethanë, dhe osht' pak a shumë nëse e merr këtë sistemin e shkollës fillore te na, shkolla e mesme masandej fillon universiteti. Aty kom studiu mediat, artin, dizajnin grafik edhe... po m'duket këto janë.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë ajo periudhë?

Saranda Bogujevci: Shumë e mirë. Kom mësu shumë gjana t'mira edhe kom taku shumë njerëz t'mirë dhe interesant. Ka qenë koxha nji... domethanë në kolegjin ku kom shku ka pasë njerëz prej shumë vendeve t'botës. Pjesa ma e madhe e tyne që kanë lindë edhe jonë rritë në Angli po që familjet e tyne kanë ardhë prej vendeve t'ndryshme. Po ka pasë edhe prej atyne që kane ardhë ma vonë, edhe ka qenë nji përvojë tëpër interesant. Mësojshe shumë, t'bijke me mësu shumë ma shumë për kulturat e tjera. Domethanë ka pasë prej Indisë, ka pasë prej Pakistanit, prej vendeve t'ndryshme të Afrikës,

Portugalisë, Palestinës, Iranit, Irakut. Ka qenë miks kështu i studentave, kështu që ka qenë një përvojë tepër e mirë.

Aurela Kadriu: Po e boj një digresion, m'fal. Kur ka qenë hera e parë mbas luftës që jeni kthyer në Kosovë?

Saranda Bogujevci: Mas dy viteve që kom shku në Angli.

Aurela Kadriu: Po i bjen viti 2001?

Saranda Bogujevci: 2001 ose... jo, po 2001. M'fal.

Aurela Kadriu: Qysh e keni gjetë Kosovën, qysh ka qenë...

Saranda Bogujevci: Pak a shumë ka qenë qajo energjia e njejtë mbas luftës. Vetëm që normal ka qenë, gjanat kanë qenë pak ma t'rregullume. Nuk ka qenë ai kaosi i mas luftës. Për mu ka qenë ndjenjë tepër e mirë që, që kom mrrri me ardhë. Se pa marrë parasyshë sa do që ishin kushtet e mira, kisha kriju shoqëni, gjithçka në Angli, m'mungojke Kosova shumë, edhe m'mungojke pjesa e familjës. Masandej dojsha me ditë ma shumë se ku ka mbetë, shoqinë domethanë që i kom pasë n'shkollë. Nji pjesë të familjës ma t'gjanë e kom fjalën, që nuk i kisha pa mbas luftës. Edhe sado që ish vështirë domethanë, nuk e kisha pjesën tjetër t'familjës. Po t'njejtën kohë ajo ndjenja e... kur kthehesh n'shtëpi. Edhe njëfarë forme gjithë e kom pasë, sa herë që kom ardhë në Kosovë. Për shembull edhe tash nëse jom në Prishtinë ose dikund se kom ardhë tash jetoj në Kosovë, po gjithëherë kur shkoj për shembull në Podujevë e kom qatë ndjenjën që kom shku përnime n'shtëpi.

Aurela Kadriu: Çka keni vazhdu mbas kolegjit?

Saranda Bogujevci: Mbas kolegjit kom vazhdu studimet në Artin Interaktiv në Manchester.

Aurela Kadriu: Në cilin universitet?

Saranda Bogujevci: Në universitetin Metropolitan të Manchesterit.

Aurela Kadriu: A na tregon çka ka ndodhë n'jetën e juaj noshta n'qetë periudhë, ne aspektin profesional, në aspektin akademik, prej që keni studiu e tutje?

Saranda Bogujevci: Prej kur... n'fillim faktikisht kur kemi shku në Angli jemi njoftu me një organizatë që, që i ndihmojke domëthanë refugjatë në Angli, po që kanë dërgu edhe ndihma humanitare në kampet në Shqipëri. Ma vonë jemi angazhu me organizatën, dhe kemi pasë projekte shumë t'ndryshme që gjithëherë kanë kontribu n'punën që e kemi ba në Kosovë. Kemi fillu me parkun e paqës të Manchesterit që osht' në Podujevë. Domethanë projekti ka fillu atëherë, domethanë kur kemi fillu me negociu me komunën e Podujevës, ka qenë 2001. Edhe kemi pasë projekte t'ndryshme.

Gjithëhere punën e kom pasë përmes artit dhe kulturës, por për vetëdijësim të qytetarëve domethanë në Angli rreth refugjatëve dhe azilantave, për shkak që gjithëhere portretizohet, sidomos nëpër media si njëfarë lloj dukunie e keqe. Edhe shumë pak njerëzit e kuptojnë arsyen pse, pse shkojnë në një vend tjetër. Për shembull qysh ka qenë rasti jonë që me shku në Angli. Edhe gjithëhere e boj këtë krahasimin me, me Suedinë domethanë. Nëse kishim... na është dhanë e drejta me jetu në Suedi, domethanë unë nashta sot e kisha pasë familjën gjallë. Dhe gjithëhere ja u spjegoj n'këtë formë që njerëzit me kuptu tamam. Edhe tjetra që gjithëhere iu flas për këtë aspekt osht' që tash si shtetase britaneze unë kom t'drejtën me zgjedhë ku du me jetu, edhe qysh du me kanë jeta jeme.

Domethanë n'momentin unë kur kom shku në Suedi me familjën edhe n'momentin kur kom shku në Angli mbas luftës, unë nuk kom pasë, nuk kom mujtë me zgjedhë. Ka qenë çështje që e kom pasë t'nevojshme për me mbijetu. Kështu që një pjesë t'madhe t'punës në Angli e kom... domethanë kom punu rreth temave, reth kësaj temës t'refugjatëve edhe t'azilantave për me i vetëdijësu qytetarët ma shumë atje. Edhe masandej një kohë t'gjatë kemi punu si familje n'realizimin e ekspozitës që e kemi pasë në Prishtinë, Tiranë edhe Beograd. Masandej mbas asaj kohe kom vendosë m'u kthy në Kosovë.

Aurela Kadriu: A na tregon, m'fal që po t'ndërpres, a na tregon ekspozitën qysh osht' organizu? Edhe mandej me na tregu përvojat në Prishtinë, në Tiranë edhe në Beograd, qysh osht' pritë edhe qysh jeni ndi ju personalisht?

Saranda Bogjuevci: Kur kemi fillu me mendu për ekspozitën, si familje kemi folë shumë, domethanë si rast osht' përcjellë shumë prej mediave ndërkombetare, dhe gjithëhere domethanë osht' dhanë ai përceptimi i gazetarit që e ka ba storien. Edhe kemi vendosë që me tregu historinë tonë ashtu qysh e kemi përjetu dhe qysh e kemi ndi. Kemi taku, përmes punës domethanë që kemi ba me organizatën "Manchesterit në ndihmë të Kosovës". Masandej kemi taku kuratorin e ekspozitës, James Walmsley, i cili e ka kuptu situatën shumë. I ka ra me punu edhe me artistë tjerë prej Kosovës. Edhe ka qenë shumë i ndjeshëm ndaj, jo vetëm ndaj familjës edhe ndaj stories, po n'kuptimin qysh e kemi pa na, dhe qysh na kemi dashtë me shfaqë qatë përjetim që e kemi pasë.

Ka marrë një kohë t'gjatë për shkak që projektet kësajsoji domethanë t'vynë kohë për m'u zhvillu. Kemi fillu me bisedu me Galerinë Kombëtare që n'atë kohë ka qenë drejtor Fahredin Spahiu. Masandej, domethanë osht' punu shumë sa i përket fondeve, domethanë ky aspekti i realizimit. Edhe kemi vendosë që, domethanë ekspozita osht' nda në katër pjesë. Edhe ideja ka qenë që kushdo që e viziton ekspozitën me kalu në njëfarë rrugëtimiti që e ka pasë familja sa i përket përjetimeve që i ka pasë.

Edhe domethanë kur hyn në ekspozitë pjesa e parë osht' dhoma e ndejës. Edhe jonë domethanë t'gjitha orenditë e dhomës t'ndejës që i kemi pasë tamam n'shpi në Podujevë. Edhe idea ka qenë që, domethanë prej krejt gjanave që i kemi pasë n'shpi edhe njana prej... Ndoshta kështu traditave që i kemi pasë brenda familjës osht' që për çdo festë dikush prej anëtarëve t'familjës na ka xhiru neve fëmijëve m'i mbajtë si kujtime. Edhe kemi pasë xhirime deri në natën e vitit të ri 1999. Po për fat të keq ushtarët i kanë gjetë fotografitë edhe krejt kasetat edhe i kanë gjujtë edhe jonë dëmtu domethanë një pjesë e madhe e tyre.

Njona që ka shpëtu osht' xhiru në vitin 1990, për natën e vitit të ri. Edhe idea ka qenë që kur vizitorët e shohin, domethanë videon, e shohin qysh ka qenë jeta e familjës, ata e kanë pa qatë videon me qatë t'nejtin ambient. Domethanë që tamam me kuptu qysh, qysh ka qenë për neve. Edhe masanej osht' pjesa, dhoma e dytë që osht' trangu i familjës ku tregon cilët anëtarë kanë mbërri me mbijetu edhe cila, cila pjesë jo.

Ka thanje n'secilën pjesë t'ekspozitës ku ndahen mendime, apo gjana që janë thanë nga anëtarët e familjës ose që i kemi përjetu. Masandej osht' dhoma e tretë, dhoma e spitalit ku i tregojna përjetimet që i kemi pasë gjatë kohës që kemi qëndru në spitalin e Prishtinës, domethanë gjate luftës. Po flasim prej marsit '99 deri në qershor '99 kur ka përfundu lufta. Edhe pjesa e fundit osht' dhoma e gjykimit ku shfaqet domethanë rrugëtimi që e kemi pasë kur kemi shku në Angli për shërim, masandej edhe lufta jonë për drejtësi. Ku kemi marrë pjesë domethanë në dy gjykime në Beograd në 2003 dhe 2008, ku jonë pesë persona të dënuar.

Masanej rrugëtimi që e kemi pasë për në Kanadë, ku kemi kërku nga Kanada të ekstradoj njonin prej të akuzuarëve që ka kërku azil atje. Edhe gjykimi domethanë, gjykimet që jonë majtë edhe në gjykatën e Hagës. Edhe kemi, osht' pjesa e fundit kur kemi shku në Angli ka qenë një fotograf që pat fotografu gjithë familjet që kanë qenë në kamp si refugjatë. Fotografitë që tash jonë në muzeun e luftës në Manchester, pjesë e një shfaqje që e kanë që thirret "Fëmijet dhe lufta" domethanë ku tregon histori të fëmijëve prej vendeve t'ndryshme, dhe prej luftave t'ndryshme. Edhe ku masandej dhjetë vite ma vonë ka realizu prapë fotografitë me një pjesë të fëmijëve, që kemi qenë fëmijë n'atë kohë po masandej si t'rritun. Edhe ku kemi edhe një shprehje domethanë që thotë që, "Të kaluarën kurrë nuk do t'a harrojmë, por që duhet të ecim para".

Aurela Kadriu: Qysh osht' pritë ekspozita në përgjithësi?

Saranda Bogujevci: Ka pasë përvoja t'ndryshme në secilin vend. Çka u kanë për neve ma s'interesanti me dhomën e ndejës që kudo që, domethanë qoftë në Kosovë, në Shqipni, në Serbi, po edhe vizitorët që i kemi pasë prej vendeve tjera të Europës... të gjithë e kanë pasë atë ndjenjën e nejtë kur e kanë pa dhomën e ndejës. Domethanë dhoma e ndejës ka qenë njëfarë, qysh me spjegu... përmes dhomës së ndejës t'gjithë e kupojshin që n'qatë periudhë kohore t'gjithë kanë jetu ngajshëm me njoni-tjetrin. Domethanë nuk paska pasë dallime t'mëdhaja mes njoni-tjetrit, domethanë qysh osht' shpërnda propagandë, sidomos në Serbi karshi shqiptarëve në Kosovë.

Dhe kur hyshin n'dhomë të ndejës ashtu i ndëgjojshe njerëzit tonë kohën t'u thanë, "Edhe na e kemi pasë qita, edhe na e kemi pasë qetë libër, edhe na e kemi pasë qesi lloj televizioni". Ose, "Edhe na e kemi pasë qesi lloj qebe, gjyshja e ka pasë kta". Domethanë në secilin vend ka qenë qajo ndjesia e nejtë domethanë, dhe komentet e nejtë. Ka qenë interesant domethanë me pa që secili ashtu e kuptojke që edhe na qito gjanat e nejtë i kemi pasë qysh i paskan pasë edhe familjet tjera në Kosovë.

Çka e kom vretë në Kosovë osht' që kur e kemi pasë ekspozitën në Prishtinë, e kom kuptu sa pak iu jepet hapsinë, edhe domethanë ende vazhdon e nejtë, familjeve për me, ose individëve për me folë për ata që e kanë përjetu gjatë luftës. Domethanë edhe e sheh sa ndikim t'keq ka qajo për ta, për shkak

që asnjë nuk e dijnë që e kanë qatë hapësinë për me folë, ose që i intereson dikujt. Domethanë kjo farë qasja, “Ka ndodhë, tash osht’ e kalumja” mendoj që osht’ shumë gabim. Duhet me u ballafaqu me t’kalumen edhe duhet me i’a dhanë secilit që ka nevojë hapësinën për me, për m’u ballafaqu me qata që e ka kalu.

Në Shqipëri ka qenë interesant masandej n’këtë aspektin... e kom pasë një përvojë me një zonjë ku e bojshin pak a shumë atë krahasimin e përvojës t’tyne gjatë kohës së komunizmit po që nuk... E shihnin luftën në Kosovë sikur, tash mos ta boj t’përgjithshme... Për shembull çka m’pat lanë përshtypje në takimin, domethanë me një qytetare të Tiranës osht’ që ajo nuk mujke me kuptu pse na kemi kërku luftë kur na jemi kanë t’lirë. E merrke n’atë aspektin në Jugosllavi ke mujtë me udhëtu ku do, a din, edhe nuk, nuk... sikur na e kemi fillu luftën, edhe na kemi kërku, i kemi pasë t’gjitha po na kemi kërku.... Domethanë e pajshë që shumë pak kishin njohuri për ata se çka ka ndodhë në Kosovë.

Në Beograd normal ka qenë përvoja krejt tjetër. Ka pasë kureshtje shumë t’madhe edhe m’u doke shumë interesant që i pajsha gjenerata t’vjetra, masandej gjenerata ma t’reja më fëmijë që shkojshin me vizitu ekspozitën. Po për neve ka qenë shumë me randësi edhe hapësina që osht’ përdorë për me shfaqë ekspozitën. Në secilin vend gjithëhere kërkojna që galeria me kanë pjesë e një institucioni publik. Jo me qenë galeri private, për shkak që masandej edhe audiencën që e ke osht’ e selektume. E për vet faktin që u kanë në Qender Kulturore të Beogradit... edhe masandej normal edhe pjesëmarrja e kryeministrit të atëherëshëm, Ivica Dacic, domethanë pat ngjallë ashtu kureshtje shumë t’madhe.

Edhe pse me një momentin masi që fillumë me vendosë ekspozitën na lajmërunë që nuk do të hapet. Kështu që ka qenë si proces shumë i vështirë, po nuk jemi ndalë. Domethanë kemi thanë, “Kemi me kry punën tonë, nëse nuk na lejoni me hapë atëhere, okej e hekim punën, e vazhdojmë dikun tjetër. Po deri sa t’vjen koha kur e kemi na datën për me e hapë edhe deri sa nuk na jepet një përgjegjje konkrete na kena me vazhdu...” M’falni, “Na kena me vazhdu me punën tonë”.

Aurela Kadriu: Domethonë ka pasë rezistencë...

Saranda Bogujevci: Po, po...

Aurela Kadriu: Prej institucioneve?

Saranda Bogujevci: Po, patjetër. Po. Para se me, domethanë në momentin që osht’ dalë njoftimi... Para se me mbri në, në Serbi për me fillu me vendosë ekspozitën në galeri, ka pasë shumë shkrime në mediat serbe që kjo osht’ një propagandë shqiptare. Natën e hapjes ka pasë protesta, gjatë gjithë kohës ka pasë, ka qenë nën, ka pasë policë përreth për çështje sigurie. Kështu që nuk ka qenë e lehtë aspak, po n’ksi momente, n’momentin që bahet e vështirë e dorëzohesh, nuk mundet me u realizu. Kështu që për neve ka qenë me rëndësi me realizu si projekt edhe me t’thanë t’drejtën as nuk kemi mendu fort për çështje sigurie as kurgjo.

Aurela Kadriu: Kur jeni kthi përfundimisht me jetu në Kosovë?

Saranda Bogujevci: Në 2014. Në maj të 2014 kom ardhë, në qershor 2014 e kom vendosë kështu që të qëndrojë për një kohë.

Aurela Kadriu: Po kthehem pak te, te pavarësia, domethonë keni qenë në Angi në atë kohë...

Saranda Bogujevci: Jo kam qenë në Kanadë (qeshë).

Aurela Kadriu: Okej keni qenë në Kanadë n'atë kohë. A na tregon pak, e mban n'mend verën e vitit 2007, ose qysh e mban n'mend verën e vitit 2007?

Saranda Bogujevci: Verën?

Aurela Kadriu: E vitit 2007, domethanë vera para shpalljes të pavarësisë.

Saranda Bogujevci: Po, tash (qeshë) tash po m'kujtohet. N'fakt ka qenë, 2007 kshtu ka qenë kohë kur shumë gjana kanë ndodhë. Kemi pasë një projekt me artistë nga Kosova që për herë t'parë jonë ekspozu në, në Angli. Kështu që, gjatë atij viti m'ka ra shumë shpesh me ardhë në Kosovë. Ka qenë, domethanë koha e studimeve, për mu kështu ka qenë një vit shumë i, i ngarkumë po me, me projekte interesante, me gjana interesante që kanë ndodhë. Në... verën e 2007-tës, muj me t'thanë pjesën ma t'madhe t'asaj kohe e kom kalu në, në Shqipëri edhe ni pjesë kom qenë në Kosovë.

Aurela Kadriu: A na tregon kur ke dëgju për herë t'parë ose kur e ke kuptu ti për herë t'parë që Kosova ka me shpallë pavarësinë?

Saranda Bogujevci: S'muj me t'thanë, osht' e vështirë se nganjherë ashtu përqendrohesh n'kujtime të caktume edhe nuk i mendon pjesën tjetër.

Aurela Kadriu: Po me çka e ndërlihdë kur menon?

Saranda Bogujevci: Me t'thanë t'drejtën pavarësinë e Kosovës e ndërlihdhi me, domethanë atë kohë kur osht' shpallë pavarësia e Kosovës unë kom qenë në Kanadë me studime, pata ba kështu shkëmbim mes Univerzitetit që kam qenë në Manchester. Dhe kam qenë për gjashtë mujë n'Kanadë domethanë edhe gjatë qasaj kohe kur osht', kur ka, kur osht' folë domethanë edhe kur osht' shpallë pavarësia e Kosovës unë kom qenë atje. Kështu gjithçka domethanë kur flitet për, për kujtimin e qasaj kohe të shpalljes të pavarësisë të Kosovës kam qenë në, domethanë e lidhi gjithë herë me, me Kanadën (buzeqeshë).

Aurela Kadriu: A na tregon çfarë domethanje ka pasë për ty pavarësia? Çka ke menu atë ditë kur u shpallë?

Saranda Bogujevci: Ka qenë t'them t'drejtën një festë e madhe, domethanë meniherë osht' oragnizu në qendër të Torontos janë mbledhë shqiptarët. M'kujtohet ma, që ka qenë nderë për mu, ma patën dhanë edhe fjalën domethanë me iu drejtu të gjithë bashkatdhetarëve që janë mbledhë në, në Toronto. M'kujtohet pata... domethanë me, me familjarët qe i kisha, dhe shoqinë që i kisha në, në Kanadë, gjithë fëmive dhe domethanë çka ishin gjenerata ma t'reja ja u pata vizatu shqiponjën, ajo n'fotografi që, që i patëm ba. Ka qenë ashtu festë shumë e madhe.

M'kujtohet një ditë para shpalljes se pavarësisë ashtu, për shkak qe si komunitet domethanë i shqiptarëve ka qenë koxha i madh edhe ku do qe ecshe, pak ashtu ta çojke mallin e, sikur me kanë në, në Kosovë. Po i pajshe domethanë me kerre, me flamur, tu festu domethanë. E masandej, t'nesermën kur u shpallë pavarësia e Kosovës ashtu, ka qenë një festë, festë e madhe. Ka qenë shumë ftoftë (qeshë) po domethanë osht', osht' festu ka qenë një festë e madhe.

Aurela Kadriu: A e keni pa *live* apo... seancën?

Saranda Bogujevci: Po, po. Patjetër, patjetër. Ma s'pari domethanë, ma s'pari e kemi, e kemi përcjellë shpalljen e pavarësisë masandej dhomethanë krejt shqiptarët të organizumë... ashtu kanë qenë rrugët e bllokume deri në qendër të Torontos për shkak që kanë ardhë domethanë t'gjithë shqiptarët që kanë qenë rreth, rreth Torontos. Patëm festu domethanë në pjesën e qytetit, qendrës t'qytetit në Toronto. Masandej ma vonë jonë bo edhe organizime, organizime tjera që janë mbledhë...

Ka qenë interesant për shkak që gjatë qasaj kohe kam taku shumë... për shkak që si komunitet osht' koxha i madh edhe, domethanë komuniteti i serbëve, kroatëve, të vendeve të Ballakanit n'pjesën ku kam qenë në Kanadë. Edhe ka qenë shumë interesant ajo përvoja me t'rijtë serb, edhe përceptimi i tyre i shpalljës t'pavarësisë të Kosovës. Pjesa ma e madhe e tyne kanë qenë domethanë shumë t'vegjël kur kanë shku në Kanadë ose kanë lindë atje. Ose pjesa ma e madhe e familjeve t'tyne kanë qenë për shembull serb prej Kroacisë ose prej Bosnjës ose.... A din, jo tamam prej, prej Serbisë. Eh ish shumë interesant me pa debatet që u bojshin mes t'rive të Kosovës domethanë edhe t'rive që ishin serb.

Aurela Kadriu: A na tregon detaje prej...

Saranda Bogujevci: Paj... u kanë shumë interesant sa, çfarë vendosmërie kishin që Kosova osht' e Serbisë edhe pse kurrë nuk kishin qenë në Kosovë, shumë pak dishin rreth Kosovës. Po ajo u vrejke shumë ashtu që osht' diçka që osht' përcjellë prej familjarëve edhe jo ata që e kuptojshin ma s'mirti. Edhe ish shumë interesant m'i pa për shembull se e kishin njifarë vendosshmërie edhe ashtu ia jepshin njifarë t'drejte vetvetës me t'thanë ty.... Me mu nuk guxojshin as me i hi atij muhabeti, kështu që kurrë nuk m'kanë thanë kurgjo për shkak që e dishin historinë e, e familjës edhe ishin shumë t'kujdesshëm. Po për shembull diskutimet që i bojshin me tjerët. Edhe e kishin atëfarë vendosshmërinë që Kosova osht' e Serbisë. Po e pajshe që ish diçka që jo n'fakt që ata e kuptojshin qaq, ose kishin besim tamam t'tyne po ish diçka që ish përcjellë prej, prej familjës. Se për shembull n'mramje kur dojshin me dalë për shkak që i pajshe, secilin vend që shkojsh, për shkak që jetojshin në një vend t'njejtë, nuk i interesojke prej cilit vend je ose harrojke ai prej cilit vend e ka familjën. Po u pajke sa shumë, çfarë influence ish domethanë direkt prej, prej familjës. Jo pse atyne iu interesojke shumë. Kështu që, edhe kjo ka qenë përvojë interesant për mu.

Aurela Kadriu: Po kthehemi te viti 2014 kur keni vendosë me u kthy në Kosovë. Pse keni vendosë m'u kthy në Kosovë? Qysh ka ndodhë komplet qaj procesi i rikthimit?

Saranda Bogujevci: Për shkak dhe të ekspozitës domethanë, muj me thonë ndoshta prej 2010 deri 2013 faktikisht, fillimit të 2014 m'ka ra shumë shpesh që me udhëtu edhe me qëndru në Kosovë. Edhe e kisha mendu domethanë nëse ish kanë mundësia me ardhë edhe me mujtë me gjetë një mënyrë, edhe n'çka kisha mujtë me kontribu domethanë për vend. Në 2014 kom ardhë me një projekt me një shoqen, me një shoqe domethanë, Besa Neziri Rugova... që ka qenë një projekt ku Besa si dizajnere e ka punu, domethanë pajën e nusërisë, ose ka ana e llapit që i thojna qeizi, që m'ka mbetë domethanë i nanës, që e kom pasë kur osht' martu me babin. Edhe njifarë forme veç pat mbetë ashtu i paluar edhe nuk dijsa çka, qysh me e shfrytëzu ose... Masandej Besa e pat dhanë këtë idenë për me i shëndrru në fustana, edhe që m'pat pëlqy shumë.

Edhe patëm, patëm marrë pjesë në festivalin FemArt, që atëhere ka pasë tjetër emër (qeshë). Edhe patëm prezantu domethanë punën e Besës që e ka ba. Idea ka qenë me, njifarë forme me tregu që edhe ajo ka qenë një formë e artit, domethanë punën që e kanë ba gratë. Po edhe t'njejtën kohë, qysh me thanë, me prezantu anën tjetër, nanën. Domethanë nuk ka qenë, si me thanë nuk... si gra nuk ka qenë jeta e tyne, dhe nuk ka qenë, qysh me thanë, ditunia ose talenti i tyne vetëm në pajë të nusërisë

domethanë që osht' ba. Të gjitha gratë domethanë kanë pasë edhe anën tjetër t'tyne, që jo ndoshta gjithëhere osht' shfaqë.

Kështu që pata ardhë me Besën me marrë pjesë në festival edhe me prezantu punën. Masandej gjatë qatij viti komuna e Prishtinës, pat ardhë në qeverisje domethanë kryetari Shpend Ahmeti dhe Lëvizja Vetëvendosje. Edhe ka qenë drejtoreshë në atë kohë Blerta Zeqiri, drejtoreshë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Edhe pata pranë për një kohë t'caktume me iu ndihmu me drejtori. Masandej Blertës iu desh me lëshu postin. Edhe kështu që m'u ofru domethanë mundësi për me e udhëheqë drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që u pata ndi t'për mirë, në kuptimin që kanë pasë besim tek unë domethanë për me marrë një përgjegjësi qaq t'madhe për kryeqytet.

Edhe, kështu që gjanat patën rrjedhë ashtu shumë pa plan... Po që ka qenë njana prej përvojave ma t'mira edhe ma sfiduse që kom pasë n'punë, nashta, po thom për shkak që gjatë jetës kom pasë sfida t'mëdhaja, thuj se gjithëherë.

Aurela Kadriu: A na tregon qysh ka qenë periudha në postin e drejtorës të Kulturës...

Saranda Bogujevci: Kom taku, kom taku shumë njerëz. Kom msu shumë, prej shumë njerëzve t'ndryshëm domethanë, sidomos sa i përket komunitetit të artistëve, fushave të ndryshme. Ka qenë interesant për mu për shkak qe e kom pa sa shumë dallon sistemi i punës tek ne n'krahësim me përvojën që e kom pasë në Angli. Kom qenë shumë me fat për shkak që ka qenë një i ekip i kabinetit domethanë t'kryetarit që shumë m'kanë përkrahë, domethanë edhe jonë kujdesë për mu. Kom qenë ma e reja (qeshë) prej drejtorëve dhe drejtoreshëve.

Edhe si punë ka qenë shumë sfiduese për shkak që ka shumë, ka pasë shumë probleme. Tjetra osht', domethanë, je duke e udhëheqë kryeqytetin, domethanë sektorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të kryeqytetit. Kështu që kërkesat jonë shumë t'mdhaja, por në të njëjtën kohë kom mësu shumë. Edhe tjetra çka m'ka, çka kom pritë me pa edhe me kuptu osht' që duhet me fillu me mësu me i besu njani-tjetrit ma shumë edhe me punu si, si komunitet. Nuk jena shumë t'organizuar si popull e kom fjalën, në atë aspekt. Edhe kemi potencial shumë t'madh, kështu që duhet, duhet patjetër me punu bashkë.

Edhe tjetra osht' që, mendoj që jo gjithëhere e kuptojna osht' që e kemi një rini t'jashtëzakonshme. Po flas për shkak edhe t'përvojës që e kom pasë në Angli. Edhe jo pse e thom kta, domethanë me ia ba qejfin vendit, ose me i'a ba qejfin vetit, po sinqerisht rinia jonë janë shumë intelegjent. Edhe kanë shume kapacitet për, për m'u zhvillu domethanë n'fusha të ndryshme. Edhe kemi kapacitet brenda një vendi kaq t'vogël që jemi, për me, me pasë domethanë kuadro t'ndryshme t'rinjëve dhë ekspert t'ndryshëm që s'kish pasë nevojë me i pasë prej vendeve tjera hiç. Edhe fatkeqësisht jo gjithëhere iu jepet mundësi edhe hapësina t'rinjëve për m'u zhvillu edhe me ecë përpara.

Aurela Kadriu: A na tregon mandej çka keni vazhdu me bo, mbas mandatit?

Saranda Bogujevci: Mbas mandatit në komunë kam shku në Angli për disa mujë. Masandej kom vendosë me ardhë prapë edhe me kandidu për deputete, si pjesë e Lëvizjes Vetëvendosje.

Aurela Kadriu: Okej, nëse nuk kemi diçka me shti atëhere ju kishim falenderu...

Saranda Bogujevci: Noshta masi osht' edhe te pjesa e pavarësisë Kosovës, kisha dashtë veç disa gjana me i thanë që duhet me i'a fillu me mendu me punu, qata që e thashë ma herët s'bashku, me kriju besim te njani-tjetri. Me mendu për një t'ardhme ma afatgjatë se sa t'mendojna vetëm sot për nesër. Edhe me pasë pak besim tek vetëvetja, që masandej kjo e lidhë një kolektiv, që mundemi edhe ne vetë me marrë vendime për vendin tonë, për qata që mendojna që osht' ma e mira për neve. Edhe

nëse gabojna nuk osht' keq, se mësojmë prej qasajna. Edhe nuk domethanë gjithëhere me ditë dikush tjetër për neve ma mirë se sa që dijmë na për vetvetën. Me pasë ndoshta një bashkëndjesi edhe me mendu për një tjetër shumë ma shumë. Edhe me dashtë vendin tamam ashtu qysh e shprehim me fjalë. Po nashta ma mirë me ba me punë edhe me tregu qata.

Jemi vend i vogël, po kemi potencial shumë t'madh. Edhe kemi, kemi mundësi. Kemi edhe aftësi edhe jemi të zotë për me mujtë me zhvillu vendin, edhe me çu, me çu vendin përpara. Po duhet secili me marrë përgjegjësinë për vetvetën edhe me qenë aktiv secili. Nuk domethanë me pritë vetëm prej, prej institucioneve ose prej politikanëve ose... po duhet si qytetarë secili me kanë aktiv në mënyrën e vet, për me kërku llogari, edhe për me punu bashkë për me, për me çu vendin përpara. Për shkak që bahën dhjetë vite prej kur u shpallë Kosova e panvarun, që gati 19 vite që kemi dalë prej, prej luftës. Edhe për vend i vogël që jena, kemi mujtë me i pasë kushtet shumë ma t'mira se që i kemi.

Aurela Kadriu: Faleminderit shumë, Saranda.

Saranda Bogujevci: Faleminderit.